RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0140/22
Data 20.06.2022
PRISHTINË

Në përputhje me nenin 29 dhe nenin 32 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, të nenit 17 dhe nenit 19 të Statutit të RTK-së, nenit 11 dhe nenit 12 të Rregullores për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së, Bordi në mbledhjen e datës 20.06.2022, merr këtë:

VENDIM

I. Për emërimin e z.Shkumbin Ahmetxhekaj, drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës, në bazë të konkursit publik dhe Rregullores për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së.

II. Me Drejtorin e Përgjithshëm do të lidhet kontratë pune me mandat 3 vjeçar, nga data 01.07.2022.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Më 23.05.2022 Bordi i RTK-së ka shpallur konkursin për drejtor të përgjithshëm të RTK-së. Në afatin e caktuar kohor kanë aplikuar gjithsej trembëdhjetë (13) kandidatë, ndërkaq nëntë (9) prej tyre i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Procedurat e Përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm dhe menaxhmentit të lartë të RTK-së.

Në procesin e intervistimit me datën 15.06.2022, janë paraqitur nëntë kandidatë. Ndërkaq, një kandidate nuk e ka vazhduar garën.

Procesi i intervistimit ka qenë i ndarë ne dy pjesë, ku në pjesën e parë kandidatët kanë prezantuar konceptin strategjik për zhvillimin e RTK-së, ndërsa në pjesën e dytë ata janë përgjigjur në gjashtë (6) pyetjet e njëjta.

Gjithë procesi i vlerësimit dhe intervistimit ka qenë tërësisht transparent. Në çdo fazë të procesit kanë qenë të ftuar monitoruesit nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare, por ka pasur edhe qytetarë të interesuar që kanë marrë pjesë në monitorim.

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 11 të Rregullores për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së, Pas vlerësimit të kandidatëve, Bordi ka hartuar listën përfundimtare të pikëve, ku në takimin e datës 20.06.2022, kandidati me numrin më të madh të pikëve, z.Shkumbin Ahmetxhekaj, i është nënshtruar votimit në bazë të Ligjit të RTK-së, ku me tetë (8) vota PËR, Bordi ka emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryetar i Bordit të RTK-së
Besnik Boletini

Këshillë juridike:

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të paraqesin padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit të RTK-së;
- Sekretarisë së Bordit;
- z.Shkumbin Ahmetxhekaj
- Kanidatëve që kanë aplikuar në Konkursin publik për Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit